

Bsc. Valmire Ramadani

“Efikasiteti i herbicidit pendimethalin varësisht nga doza e përdorimit për kontrollin e barojave në spec”

Abstrakti

Hulumtimet për efikasitetin e herbicidit pendimethalin varësisht nga doza e përdorimit për kontrollin e barojave në spec janë kryer gjatë vitit 2021 në fshatin Siqevë, Komuna e Prishtinës. Eksperimenti është vendosur sipas sistemit bllok të randomizuar me nga katër përsëritje, në eksperiment kanë qenë gjithësej gjashtë tretmane: 4 tretmane me përdorim të herbicidit pendimethalin me doza të ndryshme, një me intervenime meknike (prashitje) dhe tretmani kontroll pa përdorim të herbicideve dhe pa intervenime mekanik. Herbicidi pendimethalin është përdorur në doza të ndryshme 2 l/ha, 3 l/ha, 4 l/ha, dhe 5 l/ha para mbjelljes së specit. Barojat dominante në ngastrat kontroll ishin: *Amaranthus retroflexus* (nena e përveshur), *Chenopodium album* (minueri i bardhë), *Setaria viridis* (kostreva e blertë), *Cirsium arvense* (cirza e arave), *Convolvulus arvensis* (dredhja e arave) dhe *Galinsoga parviflora* (galinsog lulevogël). Nga 14 lloje të barojave të regjistruara në spec, 76.0% ishin gjethegjëra kurse në përqindje më të vogël gjethengushtat me 24.0%. Sa i përket ciklit biologjik 64.0% ishin njëvjeçare, edhe numri i llojeve shumëvjeçare ishte relativisht i lartë me 36.0%. Efikasiteti më i lartë për kontrollin e barojave është arritur në ngastrat ku është përdorur pendimethalin me dozë prej 4.0 l/ha me 87.5% dhe 5.0 l/ha me 86.7%. Gjithashtu edhe rendimenti më i lartë është arritur në ngastrat ku është përdorur pendimethalin me dozë prej 5.0 l/ha me 28.7 t/ha dhe 4.0 l/ha 27.3 t/ha.

Fjalet kyçe: speci, barojat, pendimethalin, rendimenti